

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË " Gastro Care " SH.P.K.

Sot, me datë 26.09.2024

- *Z. Altin Cekodhima .zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500,000 Lek dhe 500,000 Lek të kapitalit themeltar.*
- *Zj. Gentiana Cekodhima zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500,000 Lek dhe 500,000 Lek të kapitalit themeltar..*

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Gastro Care.**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### NENI 1

##### EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**Gastro Care “ Sh.p.k.**

#### NENI 2

##### SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake nr.7, Rruga “Ndre Mjeda”, ndërtesa nr.31, hyrja nr.2 Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### NENI 3

##### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

#### NENI 4

##### OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Kryerja e vizitave dhe shërbimeve mjekesore ku përfshihen kryesisht në specialitetin e Gastro Hepatologjise dhe shërbimet e lidhura me këto aktivitet. Laborator Klinik- Biokimik Mikrobiologjik. Shërbime në disa specialitete mjekesore për vizita dhe konsulta mjekesore, diagnostikime. Ofrimi dhe kryerjen e shërbimeve mjekesore spitalore duke përfshirë, Citologji, Biopsi, Molecular Biology, Frozen Biopsi.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1,000,000 Lek dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Altin Cekodhima** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500,000 Lek dhe 500,000 Lek të kapitalit themeltar.
- **Zj. Gentiana Cekodhima** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500,000 Lek dhe 500,000 Lek të kapitalit themeltar..

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicën e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Altin Cekodhima** i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Z. Altin Cekodhima**

**Zj. Gentiana Cekodhima**